

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"2ID – HIDROTERM" sh.p.k.

Në Tiranë, sot me datë 13.07.2023, (dymijë e njëzet e tre), unë i nënshkruari i mëposhtëm:

Irjan Isuf DALLIU, i datëlindjes 22.02.1987, lindur në Shkallë, Mat dhe banues në Tirane, madhor dhe me zotësi të plote juridike dhe për të vepruar, i identifikuar me Letërnjoftimin ID Nr. personal 1702220171,

*me cilësinë e "Ortakut Themelues", redaktoj këtë akt themelimi, nëpërmjet të cilit deklaroj së me vullnet të lire të plote e të sigurtë, dhe iniciativën e lirë private, mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Kodin Civil në fuqi, në ligjin 9901 datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", me ndryshimet përkatëse, në ligjin "Për QKB", në Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijoj shoqërinë tregtare, me përgjegjësi të kufizuar, me emërtimin "**2ID – HIDROTERM**" sh.p.k.*

KREU I

Emërtimi, Forma Juridike, Selia, Kohëzgjatja, Objekti

Neni 1

Emërtimi

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është "**2ID – HIDROTERM**" sh.p.k.

Neni 2

Forma Juridike

Shoqëria "**2ID – HIDROTERM**" sh.p.k., është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë e quajtur "Shoqëria"), e themeluar nga personi fizik i sipërpërmendur, i cili nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkuara.

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Neni 3

Selia

Shoqëria e ka selinë në, Bashkinë Kamëz, Njësia Administrative Paskuqan, Rruga "Konferenca e Bujanit", Ndërtesa 5.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

Neni 4

Objekti

Punimeve Hidraulike, Mekanike dhe Elektrike për objekte civile, sociale, banimi, edukimi dhe industriale, si edhe aktivitet në fushën e energjetikes, punimeve të ndërtimit, transportit.

Tregtim dhe instalimi i impianteve mekanike, sistemeve të kondicionimit, pompa nxehtësie, chiller, aspirimi dhe ventilimi, pajisje te sistemeve të ngrohje-ftohjes, impianteve hidrosanitare, kaldaja per ngrohje me pelet dhe gaz, panele diellore, pompa të ndryshme etj., montimi, kolaudimi, shërbime servisi dhe mirembajtje.



Projektim, ndërtim dhe instalim të impianteve të ujit të pijshëm dhe ujërave të zeza, të rrjetit ujësjellës kanalizime dhe energjetikes. Studim, projektim dhe hartim dokumentacioni për projekte inxhinierike të ndryshme, si hidrosanitare, kondicionimit, elektrike, elektronike, IT etj. Konsulence, projektim dhe studim ne fushen energjitike, aduditim energjie ne ndertesa, proces dhe transport. Hartim dhe perpunim i raporteve te auditimit dhe menaxhimit te energjise.

Ndërtim në fushën hidroteknike, energjetike, mjedisit, ujësjellës dhe kanalizime, dhe sektorë të tjera të industrisë. Projektim, ndërtim dhe furnizim të impianteve fotovoltaike për prodhimin e energjisë. Punime elektrike në tension të ulet, të mesëm, të larte.

Import, export, shitja me shumicë dhe pakicë e pajisjeve dhe sistemeve, elektrike, elektronike, hidraulike dhe të sistemeve për mbrojtjen nga zjarri, pajisje ndricimi, sistemet e detektimit te zjarrit, sisteme vezhgimi me kamera, sisteme audio, materiale ndertimi, pjese kembimi, pajisje teknologjike, etj. Impiante hidrosanitare, pishinash, kuzhina, lavanderi, si dhe mirembajtja e tyre. Punime Hidraulike, Mekanike dhe Elektrike në objekte civile, sociale, apartamene dhe objekteve banimi, edukimi dhe industriale

Import dhe eksporti me shumice dhe pakice për qëllime instalimi apo tregtimi per pale te treta të pajisjeve, materialeve dhe aksesoreve për impiante hidrosanitare, elektrike, teknologjike dhe mekanike, kondicionimi, aspirimi, ventilimi, ngrohje-ftohje, hidrosanitare dhe mbrojtjes kundra zjarrit, impiante të trajtimit dhe filtrimit të ujit te pijshem dhe sanitar, pishina te hapura dhe te mbyllura, ujësjellës dhe kanalizime, vepra kullimi dhe ujitje, procese industriale, impiante rregullimi dhe kontrolli, materiale dhe pajisje elektrike dhe elektronike, etj. Tregtim materiale ndertimi dhe vegla pune.

Projektimi dhe punime te sistemeve elektrike te fuqise ne objekte civile dhe industriale. Projektim dhe ndertim i nenstacioneve elektrike primar dhe sekondar, kabinave elektrike TM/TU, linjave elektrike te TL. Punime elektrike te ndricimit te ambienteve te brendshme dhe te jashtme, ndricimit te emergjences dhe evakuimit, ndricimit rrugor, shesheve, ndricimit skenik dhe dekorativ, ndricimit te ambienteve te medha sportive, porteve, aeroporteve, si dhe projektim i sinjalistikes ndricuese ne infrastrukturen rrugore etj. Projektim dhe ndertim i sistemeve te kontrollit, monitorimit dhe automatizimit BMS dhe SCADA ne industri dhe ndertesa.

Projektim dhe instalim, dhe punime te sistemeve te automatizimit smart home per ndertesa, hoteleri, zyra, qendra tregtare etj. Projektim dhe punime te rrjeteve te telefonise, internetit, fibrave optike, CCTV, citofoni, TV, sistemet e detektimit te zjarrit, akses kontrollit dhe sistemet e alarmit.

Neni 5

Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në QKB.

KREU II KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është **100.000 (njëqind mijë) lekë** dhe është i përbërë nga **1 kuotë**.

Kapitali i regjistruar i Shoqërisë është tërësisht i nënshkruar, i papaguar, në 1 kuotë me vlerë, që përbëjnë 100% të kapitalit të shoqërisë, që zotërohet nga Ortaku i shoqërisë si më poshtë:



- 1- **IRJAN DALLIU**, zotëruesi i 1 kuote, që përbën 100 % të kapitalit të përgjithshëm të shoqërisë, me vlerë të përgjithshme 100.000 (njëqind mije) lekë.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme. Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajshme/të paluajshme apo të drejta)

Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cenimit.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Ky statut kushtëzon kalimin e kuotave të tretëve jashtë shoqërisë, me miratimin e shoqërisë dhe të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë, sipas modaliteteve dhe shumicës së cilësuar që kërkon ndryshimi i statutit.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirish të transferueshme ndërmjet ortakëve.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirish të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 8


Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

Irjon Dalliu 

- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, vendos me votat e të paktën tri të katërtave të zotëruesve të kapitalit të shoqërisë, qe janë pjesëmarrës në mbledhje.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Neni 10

Administrimi

Shoqëria do të administrohet nga një administrator.

Administrator i shoqërisë do të jetë Z. **IRJAN DALLIU**, i cili do të ushtrojë funksionet në këtë detyrë për një periudhë **5 vjeçare me të drejtë ripërtëritje**.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti, apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

Përveç kësaj, administratori shkarkohet nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të çdonjërit prej ortakëve.

Tagrat e përfaqësimit të administratorit do të jenë të pakufizuara dhe çdo ndryshim i tyre njoftohet për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit. Administratorët mund të përfaqësojnë shoqërinë së bashku ose veç njëri nga tjetri dhe mund të prokurojnë të tretë për përfaqësim të tyre. Emërimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 11

Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;



- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
 - c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - ç) përgatiti dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
 - d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
 - e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- Administratori është i detyruar të thërrasë asamblenë e përgjithshme edhe në rastet kur :
- Asambleja e përgjithshme thirret pasi, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe,
 - kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon së të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke pasur parasysh faktin së vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 12

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 13

Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Asambleja e Ortakëve merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".

Arjon Balliu

Neni 14

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 15

Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 16

Dispozita përfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua në 2 ekzemplarë me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhën shqipe pasi miratohet në parim dhe nen për nen nga ortaku i vetëm i shoqërisë tregtare, nënshkruan në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën e tij origjinale.

ORTAKU I SHOQËRISË

IRJAN DALLIU

